



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni Pranveror

Komisioni për Integritime Evropiane

Mbledhja nr. 10.

Prishtinë, më 16.01.2018, në ora 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Blerta Deliu-Kodra, Zenun Pajaziti, Armend Zemaj, Ilir Deda, Ahmet Isufi dhe Milaim Zeka.

Munguan: Fikrim Damka, Fatmire Kollçaku, Fitore Pacolli, Glauk Konjufca dhe Adem Hoxha.

Pjesëmarrës të tjerë: përfaqësuesi nga GLPS-ja, GIZ-i, OSBE-ja, NDI-ja, KDI-ja dhe mediat.

Mbledhjen e kryesoi znj. Blerta Deliu- Kodra, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 3. Të ndryshme.**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

- 2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**

Blerta Deliu-Kodra, kryetare, paraqiti opinionin ligjor lidhur me këtë Projektligj. Ajo tha se ky projektligj përcakton rregullat dhe procedurat themelore për administrimin e tatimit në pronën e paluajtshme nga Komunitet dhe Ministria e Financave.

Sa i përket çështjeve që kanë të bëjnë me tatimin në pronën e paluajtshme, këto çështje nuk janë të rregulluara me legjislacionin e BE-së, por mbeten kompetencë e brendshme e shteteve anëtare.

Andaj, konstatoj se Projektligji për tatimin në pronën e paluajtshme, së bashku me amendamentet e Komisionit Funkcional, nuk rregullohen me legjislacion të BE-së dhe mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

Kryetarja hodhi në votim Projektligjin me raportin me amendamente dhe pas votimit konstatoi se Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme me amendamentet e Komisionit Funkcional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe si i tillë mund të rekomandohet Kuvendit për miratim.

3. Të ndryshme.

Kryetarja njoftoi anëtarët e Komisionit se delegacioni për MSA-në do të udhëtojë nesër në Strasburg . Paraprakisht, tha se një ditë më parë jemi mbledhur për të diskutuar rreth takimit.

Milaim Zeka pyeti për përbërjen e delegacionit dhe cilët anëtarë janë nga Komisioni ynë.

Kryetarja tha se kryetar i KPSA është Memli Krasniqi, kurse nga komisioni ynë anëtarë janë, Armend Zemaj, Blerta Deliu, kurse nga komunitet, Adem Hoxha.

Mbledhja përfundoi në orën 13:30

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit

Kryetarja e Komisionit,

Blerta Deliu-Kodra
